

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

03.03.2025

Ora 13:47

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e rregullave për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve dhe krijimin e komisionit të qendrës së votimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|------------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Z. E. Meta, z. B. Kodra |
| • Parti | Politike: | PS (znj. E. Xhina) PD (z. F. Nuri) |
| • OJQ: | | Nuk ka prezent |

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të partive politike. Në mbledhjen e sotme kemi në rendin e ditës, shqyrtimin e një projektvendimi “Për miratimin e rregullave për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve, krijimin e komisionit të qendrës së votimit

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”. Para se të fillojmë shqyrtimin e këtij projektvendimi do të pyesja nëse kemi çështje jashtë rendit të ditës për të trajtuar, kolegë? Përfaqësues të partive politike? Jo. Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, është një projektvendim që ka ardhur për shqyrtim në Rregullator me iniciativë të Komisionerit. Do t’i lutesha zotit Meta një prezantim të shkurtër të projektvendimit dhe të relacionit.

Z. E. Meta: Përshëndetje të nderuar! Në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, është e domosdoshme të sigurohet që të gjithë qytetarët, përfshirë ata që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar. Kjo kërkon krijimin e qendrave të posaçme të votimit dhe hartimin e listave të zgjedhësve për rreth 3030 te burgosur ne këto institucione. Për të garantuar transparencë, integritet dhe akses të barabartë në procesin zgjedhor, është e nevojshme të përcaktohen rregulla dhe procedura të qarta. Projektvendimi i paraqitur për shqyrtim dhe miratim përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, hartimin dhe administrimin e listës së zgjedhësve në këto institucione, si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit. Projektvendimi synon të sigurojë që zgjedhësit, në këto institucione të kenë mundësinë të votojnë në mënyrë të fshehtë dhe të sigurt, duke përmbushur standardet për organizim, siguri dhe aksesueshmëri. Ai përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit dhe administrimin e listës së zgjedhësve në IEVP, si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit për zgjedhjet për Kuvend. Drafti parashikon që kryetari i bashkisë përgatit listën e zgjedhësve në përputhje me kreun II, të pjesës III të Kodit Zgjedhor si dhe përcakton që KZAZ merr vendim për ngritjen e qendrave të posaçme të votimit dhe propozon krijimin e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

komisioneve të qendrës së votimit. Gjithashtu është parashikuar që votimi në IEVP të zhvillohet në prani të personelit të policisë së burgjeve, KQV-së dhe vëzhguesve, duke siguruar që procesi të jetë i rregullt dhe i sigurt. Projektvendimi u është dërguar për konsultim partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike pranë KQZ-së ka shprehur shqetësime mbi projektvendimin e përcjellë për njohje, duke argumentuar se ai bie në kundërshtim me standardet e Kodit Zgjedhor dhe praktikën gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor. Kryesisht, ai ngre këto çështje: drafti nuk respekton minimalisht standardet dhe parimet e Kodit Zgjedhor, duke cenuar rregullat e përcaktuara për të drejtën e votës. Sipas praktikës së Kolegjit Zgjedhor, e drejta e votës lidhet me vendbanimin, jo me vendqëndrimin dhe ky rregull nuk mund të ndryshohet. Kërkohet që në akt të përcaktohet qartë se në listat e zgjedhësve në IEVP të përfshihen vetëm ata që kanë vendbanimin në zonën zgjedhore përkatëse dhe jo ata që kanë vetëm vendqëndrimin. Sipas Partisë Demokratike, drafti parashikon një favorizim të padrejtë për të dënuarit duke u mundësuar votimin në bazë të vendqëndrimit, gjë që nuk aplikohet për shtetasit në gjendje të lirë. Kjo bie në kundërshtim me standardet e vendosura nga jurisprudenca dhe krijon hapësira për abuzime. Partia Demokratike duke iu referuar vendimit nr. 40, dt. 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese sjell ne vëmendje se ky vendim ka përcaktuar qartë se e drejta e votës për të burgosurit është e kufizuar. Kodi Zgjedhor, si një ligj me shumicë të cilësuar, prevalon ndaj ligjit për Gjendjen Civile dhe duhet të respektohet. Drafti është në kundërshtim, sipas Partisë Demokratike dhe me një interpretim të Kolegjit Zgjedhor mbi çështjen e Rrogozhinës, ku është theksuar se vendbanimi është kriteri i vetëm i vlefshëm për përbërësin zgjedhor. Gjithashtu sugjerohet krijimi i një mekanizmi kontrolli nga partitë politike dhe KZAZ-të për të siguruar që listat e votuesve të dënuar të përputhet me kriterin e vendbanimit dhe të shmangen manipulimet. Në lidhje me këto pretendime administrata e KQZ-se

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

vlerëson se: në vendimin nr. 28/2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, ky i fundit ka vlerësuar se pavarësisht kohës që ka kaluar nga dalja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të cituar më sipër, në thelb edhe Kodi Zgjedhor në fuqi, e lidh të drejtën e votimit për kryetarët e bashkive, me të pasurit e vendbanimit në territorin e bashkisë përkatëse. Në vendimin nr. 29/2023 të çështjes “Bashkë Fitojmë” kundër KQZ-së” në të cilën ndër të tjera kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në Qendrën e Votimit nr. 2565/01 në I.E.V.P “Burgu Kosovë”, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh, kolegji ka lënë në fuqi argumentimin e KAS, në KQZ, i cili ka vlerësuar se votimi me vendim gjyqësor i 20 personave, që ndodhen në kujdesin e I.E.V.P Belsh është votim i ligjshëm dhe nuk përbën shkelje që cenon procesin zgjedhor. Në projektvendimin e propozuar për miratim nuk përcaktohet në asnjë moment se të burgosurit me vendqëndrim do të kenë të drejtën e votës automatikisht. Vendimi parashikon që Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale i dërgojnë bashkive listën e të burgosurve me vendqëndrim, por janë zyrat e gjendjes civile që hartojnë listën përfundimtare të zgjedhësve, duke respektuar rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Krijimi i qendrave të posaçme të votimit në institucionet e vuajtjes së dënimit nuk është një risi, por një praktikë e konsoliduar në të gjitha proceset zgjedhore pararendëse. Në të gjitha zgjedhjet e mëparshme, të burgosurit që kanë pasur të drejtën për të votuar e kanë ushtruar atë përmes vendimeve të gjykatës ose të përfshirjes në listën e zgjedhësve nga organet e vetëqeverisjes vendore. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor 28/2023 i referohet vetëm zgjedhjeve lokale, duke trajtuar specifikisht çështjen e votimit në këtë kontekst. Shqetësimi që kërkon të adresojë ky projektvendim lidhet me ushtrimin e të drejtës së votës nga rreth 3036 të burgosurve, të cilët sipas praktikës së mëparshme janë regjistruar dhe kanë votuar mbi bazën e vendimeve gjyqësore. Vendimi për krijimin e qendrave të posaçme është bazuar në parimet e ligjshmërisë dhe praktikave të mëparshme zgjedhore dhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

KZAZ-të kanë rol vendimmarrës për krijimin apo moskrijimin e qendrës së votimit. Në nenin 4 të projektvendimit parashikohet kompetenca e KZAZ-së për të krijuar QV dhe në këtë kontekst partitë politike të cilët kanë propozuar anëtarët e tyre në KZAZ kanë akses edhe në dokumentacion. Në këtë kontekst, pretendimet e Parisë Demokratike mbi projektvendimin nuk gjejnë pasqyrim në draftin e dërguar para jush për shqyrtim dhe miratim. Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor ju paraqet, si Komision Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin.


Znj. I. Nano: Faleminderit z. Meta! Fillojmë shqyrtimin e projektvendimit në parim, z. Çakaj!

Z. M. Çakaj: Faleminderit znj. Kryetare! Atëherë unë e dëgjova me vëmendje relatimin nga drejtori i KQZ-së të këtij projektakti. Paraprakisht kisha dy pyetje dhe një saktësim, së pari në lidhje me relatimin tuaj, më konkretisht mbrotja që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë për Kolegjin Zgjedhor, ju jeni referuar, më saktë ju cituat që votimi, kriteri i vendbanimit vlen vetëm për zgjedhjet për kryetar bashkie, vazhdoni t'i qëndroni të njëjtit dhe nëse po një referencë ligjore?

Z. E. Meta: Për sa kohë në vendimin e 28 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor vlerësohet si e tillë edhe referimi i vendimit 40 të Gjykatës Kushtetuese, që në interpretim bëhet në këtë kuadër, pra për zgjedhjet vendore.

Z. M. Çakaj: Atëhere edhe për administratën, por edhe për kolegët, unë sjell në vëmendje tuaj nenin 44 të Kodit Zgjedhor për “Kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhësve” dhe në nenin 44 këto kritere janë: “a. Të ketë shtetësinë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

shqiptare. b. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç qoftë dhe në datën e zgjedhjeve”, pika “c” është shfuqizuar, “ç. Të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile” dhe pika “d. Të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit”, pastaj pika “dh. Të regjistrohet zgjedhës vetëm në listë të një zone të një qendre votimi”, më tej akoma neni 45 “Përbërësi zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, një nga kriteret dhe një nga përbërësit zgjedhor të zgjedhësit është edhe kodi i vendbanimit, pra në të dyja këto nene të Kodit Zgjedhor përcaktohet së pari që vendbanimi është kriter i detyrueshëm për t’u përfshirë në listën e zgjedhësve dhe së dyti, të dy këto parashikime, të dy këto nene të Kodit Zgjedhor, së pari përfshihet në pjesën e tretë zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve, që nga pikëpamja teknikës legislative nuk e kemi ndarë në kapituj, pra listat e zgjedhësve për zgjedhje të përgjithshme apo listat e zgjedhësve për zgjedhje të përgjithshme për Kuvendin apo listat e zgjedhësve për zgjedhje të përgjithshme vendore, pra nuk e bën këtë kategorizim Kodi Zgjedhor, së pari. Së dyti arrijmë në përfundimin, të paktën nga leximi i këtyre dy neneve që kriteri i vendbanimit është i detyrueshëm. Kështu që në këtë kontekst unë e kam parë dhe projektvendimin e propozuar, unë besoj se është i qartë i Kodit Zgjedhor, ku parashikohet që vendbanimi është një kriter i cili nuk mund të interpretohet dhe nuk mund të anashkalohet ose zëvendësohet me një kriter tjetër, qoftë edhe vendqëndrim në rastin konkret, si e keni propozuar ju Kodin. Gjithsesi kjo i takon diskutimit në nenin përkatës.

Znj. I. Nano: Faleminderit koleg! Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Faleminderit! Për sa dëgjuam relacionin e relatuar nga drejtori që mbulon çështjen përkatëse, z. Meta, në fakt prisja që të gjeja referenca konkrete ligjore, të cilat jo vetëm duhet t’i përmbante Kodi, por të garantonin të gjithë masën

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

e propozimit. Referenca ligjore e përdorur, vetëm neni 20, pika përkatëse e cila referon se kjo është kompetencë e Komisionit Rregullator sepse normojmë akte dhe së dyti është përdorur neni 43 i Kodit Zgjedhor. Po t'i referohemi, neni 43 të Kodit Zgjedhor, neni 43 i Kodit Zgjedhor, të nderuar, nuk ezauron dhe nuk shteron të gjithë masën e propozuar si titull, pra, "Përbërja dhe përgjegjësitë e KQV-ve të posaçme" thotë neni 43, ndërkohë që titulli është: "Vendim për miratimin e rregullave për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025". Dakord me nenin 43, i cili padiskutim që është një nen që i përket anës procedurale të krijimit dhe përpara se të ketë anë procedurale të krijimit të një komisioni në qendrat të votimit të karakterit të posaçëm, siç janë IEVP-të duhet patjetër që të ndiqet nga kritere të kushtëzuara, të cilat përcaktojnë jo vetëm kushtet sesi duhet të përzgjidhen ata që duhet të votojnë por në të njëjtën kohë ruajnë dhe kanë karakter unifikues, pra janë të barabarta për të gjithë zgjedhësit. Këtë unë nuk e gjej mesa u relatua dhe mesa na është përcjellë, as në relacion dhe as të përdorur në preambul si bazë ligjore. Për shembull, ashtu siç dhe kolegu e përmendi, neni 44 i Kodit Zgjedhor përcakton kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhësve. Cila është arsyeja që ju nuk jeni përmbajtur kësaj dispozite dhe për më tepër a keni cituar këtë dispozitë në përmbajtjen e këtij projektakti sepse kjo është një dispozitë referuese e domosdoshme, e cila përcakton dhe ndan se cilat janë kriteret dhe një prej kriterëve, të nderuar, është pika "ç" dhe "d"? Pika "ç" thotë: "Të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile" dhe automatikisht më pas shkojmë tek zbërthimi sesi bëhet ose sesi realizohet kjo pikë, te germa "d", "d. Të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit". Vendbanimin nuk e pashë si fjalë dhe as si kriter, bazën ligjore jo e jo, cila ka qenë arsyeja që ju jeni shmangur

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

të njëjtit kriter që përdoret për të gjithë zgjedhësit, për të gjithë ata që do të përfshihen në listat e zgjedhësve dhe është një kriter unik që duhet patjetër të jetë në unison për të gjithë dhe i barabartë, mund ta di këtë shmangie nga Kodi?

Z. E. Meta: Nuk ka asnjë shmangie, siç e referova dhe në relacion, në projektvendimin e propozuar, nuk përcaktohet në asnjë moment se të burgosurit me vendqëndrim do të kenë të drejtën e votës automatikisht. Pra vendimi parashikon që Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale u dërgojnë bashkive listën e të burgosurve me vendqëndrim, por janë zyrat e Gjendjes Civile të cilat hartojnë listën përfundimtare në përputhje me kreun II, pjesa e tretë të Kodit Zgjedhor.

Znj. H. Vukaj: Atëherë pse duhet t'i fusni ju në qorrsokakun ose në "tricky ëay" të gjithë drejtuesit e IEVP-ve që të përcaktojnë një listë kaq të madhe dhe pastaj të jetë ajo e DPGJC-së të bëjnë nderin që t'i voton, ti s'voton? Ndërkohë që kriteret, kriteri është i qartë dhe thuhet: "Të gjithë përfshihen në lista sipas vendbanimit", vendbanimin nuk e shoh si kriter, nenin 44, i cili është nen unik për të gjithë shtetasit shqiptarë mbi 18 vjeç nuk e shoh të përdorur. Mbi ç'bazë e keni ngritur këtë dhe merrni iniciativën dhe kurajon të na propozoni një gjë që është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor?

Z. E. Meta: Atëherë në rast se flasim për kompetencë, kompetenca për hartimin e listës të zgjedhësve është e zyrave të Gjendjes Civile, më saktë të bashkive dhe jo e IEVP-ve dhe në këtë kontekst ne nuk mund t'i japim tagrat një institucioni, nuk ka tagër të hartojë listën e zgjedhësve sepse po t'i themi që IEVP-ja përgatit listën e zgjedhësve i bie që ata janë hartuesit e listës së zgjedhësve.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Znj. H. Vukaj: Nuk tha askush që I EVP-ja përgatit, por I EVP-së, mos i jepni edhe burokracinë e shtuar por edhe mundësinë për abuzime dhe në atë listë edhe persona të cilët nuk kanë vendbanimin që plotësojnë kriteret e vendbanimit. Pra unë personalisht në masën që ju keni propozuar ose keni tejkalluar këtë kriter, i cili përdoret për të gjithë shtetasit shqiptarë jashtë këtyre qendrave të posaçme të vuajtjes së dënimit, unë nuk e gjej me vend. Në parim, padiskutim jam dakord, që t'i realizohet dhe t'i jepet mundësia të votojnë të gjithë atyre që e kanë të pakufizuar këtë të drejtë të garantuar nga Kushtetuta, por kriteret janë në unison të njëjta dhe të barabarta për të gjithë. Më tej kemi nenin 45 i cili thotë "Përbërësit zgjedhorë" e përmendi më herët kolegu, që në germën "ë" të përcakton kodin e vendbanimit, domethënë këto janë kriteret përforcuese që rrinë në të njëjtin standard dhe unë nuk e kuptoj që pse nuk janë përdorur për referencë ligjore, ndërkohë që padiskutim do të lehtësonit dhe atë drejtuesin e institucionit të I EVP-së, që të bënte një listë më të thjeshtë, pa komplikacione, ku ruheshin të gjitha masat e zbatimit të barabartë të kriterëve ligjore e kështu me radhë, te neni 46 lista e zgjedhësve është përsëri kriteri vendbanim i cili është kriter kushtëzues. Personalisht nuk jam dakord me kriterin e përjashtimit, ose përjashtues, ose të ndryshëm nga kriteri i përgjithshëm që ju keni përdorur.

Znj. I. Nano: Nëse mundem një diskutim, një pyetje, nisur nga ato çka relatuat dhe nga diskutimet e deritanishme të kolegëve, pra mesa unë kuptoj duke lexuar aktin, tagri që ju nëpërmjet këtij projektakti i keni dhënë drejtuesve të I EVP-ve është të identifikojnë cilët janë të burgosurit që janë në atë I EVP dhe mes këtyre identifikojnë ata që janë me të drejtë vote dhe ata të cilët e kanë humbur të drejtën e votës për shkak të ligjit të "Dekriminalizimit". Pra, tagri i drejtuesve të I EVP-ve është vetëm të identifikojnë dhe normalisht ata identifikojnë çfarë kanë në institucionin e tyre të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

ekzekutimit të veprave penale, që në një kuptim është vendqëndrimi, kjo nuk do të thotë që automatikisht këta do të votojnë. Kjo listë i dërgohet kryetarëve të bashkive përkatëse dhe zyrat e Gjendjes Civile në bashkitë përkatëse pastaj do të hartojnë listat.

Z. E. Meta: Kjo është dhe një praktikë, mbështetet në praktikën ekzistuese, sesi rikuperohet nga IEVP-të, pra institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale me zyrat e Gjendjes Civile pranë bashkive.

Znj. I. Nano: Nga eksperiencia e deritanishme, supozojmë, por nuk e kemi pasur një akt të tillë, cila është procedura që ndiqet në komunikimin mes drejtuesve të IEVP-ve dhe kryetarëve të bashkive, në ato bashki ku ka IEVP, pra deri tani, pavarësisht këtij akti?

Z. E. Meta: Jua thashë pak më parë është e njëta procedurë.

Znj. I. Nano: Është e njëjta procedurë, dakord. Faleminderit!

Z. E. Meta: Më ndjeni, thjesht për plotësim, në dallim me vendimin këtu përcaktohen disa afate, të cilat realisht në terren nuk janë respektuar dhe ka vështirësuar punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe duke i afruar...

Znj. I. Nano: Duke i afruar drejt ditëve të fundit para zgjedhjeve.

Z. E. Meta: Po, krijimi i qendrave të posaçme është bërë edhe dhjetë ditët e fundit.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Znj. I. Nano: E kuptoj, faleminderit! Po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë, nga sa po relatohet dhe nga diskutimet, qoftë të Komisionit Rregullator, qoftë të administratës së KQZ-së, në vlerësimin tim, në rastin më të mirë do të rezultojë që kemi një mungesë parashikimi të një hallke në këtë akt. Jam dakord që drejtori i IEVP-së identifikon të gjithë zgjedhësit me të drejtë vote, që do të thotë të burgosurit ndahen në dy kategori, ata që e kanë të drejtën e votës dhe ata të cilët nuk e kanë të drejtën e votës në bazë të ligjit të “Dekriminalizimit”. Në rastin konkret pasi kryen këtë procedurë, ajo çfarë i mungon këtij është që nga ju është shprehur në terma të përgjithshëm, por nëse ne si organ Rregullator nuk e rregullojmë dhe nuk e materializojmë në këtë projektakt potencialisht mund të prodhojë pasoja që do të thotë pas pikës 5 të nenit 3 do të duhet nëse me se s’bën, që nëse kolegët bien dakord ne të normojmë që vetëm qoftë dhe me një fjali, vetëm të burgosurit të cilët, ose të paraburgosurit, vetëm ata të cilët kanë të drejtë të votojnë në qendrat e posaçme të votimit, ata zgjedhës të burgosur të cilët ose të paraburgosurit, të cilët kanë, plotësojnë kriteret e nenit 44 dhe nenit 45 të Kodit Zgjedhor, është e nevojshme ta theksojmë këtu se përndryshe konfuzon aktin. Nëse kolegët bien dakord me këtë, edhe jo vetëm në parim por edhe për përmbajtjen e aktit jemi të qartë, pra mos ta lëmë siç ndodhi në Rrogzhinë, qoftë në tagrin e kryetarit të IEVP-së apo të njësisë vendore apo drejtorit përkatës të Gjendjes Civile që të prodhojë atë paqartësi dhe sigurisht të prodhojë një pavlefshmëri të caktuar, nëse kolegët bien dakord, e normojmë pas pikës 5 dhe është e zgjidhur.

Znj. I. Nano: Zoti Çaka!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Z. D. Çaka: Faleminderti zonja Kryetare! Tani në vlerësimin tim mendoj që kriteret e përcaktuara në nenin 44 dhe 45 të Kodit Zgjedhor, por rrjedhimisht dhe 46 lidhen me, po themi me kriteret për përfshirjen e zgjedhësit, pra kriteret fillestare, përfshirë si zgjedhësit në listën e zgjedhësit dhe përbërësit të zgjedhur. Çfarë do të thotë kjo? Po bëhet fjalë për shtetas të cilët pavarësisht se iu është hequr e drejta për të ushtruar lirisht pra lëvizjen apo dhe kufizime të tjera nuk u është hequr e drejta për të votuar. Këta zgjedhës e kanë këtë të drejtë, por në qoftë se do të bëjmë një krahasim me këto dy nene do të duket sikur këta zgjedhës nuk ekzistojnë në asnjë listë zgjedhësish me këtë logjikë sepse themi që nuk plotësohen kriteret e neneve 44, 45 të Kodit Zgjedhor, po ndërkohë këto kritere dhe këta përbërës janë për listën bazë dhe këta zgjedhës janë në një listë bazë, janë të regjistruar në një listë në vendin e tyre ku janë të regjistruar në Gjendjen Civile, por për shkak të pamundësive ata nuk mundet ta ushtrojnë këtë të drejtë. Atëherë pyetja ime çfarë do të ndodhë nëse, pra këtu nuk kemi të bëjmë me shtetas të cilët nuk e kanë një kriter, pra mund të kenë kritere të tjera, këtu nuk futen shtetasit e huaj të cilët nuk janë pjesë e listës së zgjedhësve, këtu përbërësit kryesorë të listës së zgjedhësve dhe kriteret për përfshirje janë të plotësuar njëherë për këta zgjedhës dhe janë të plotësuar aty ku ata kanë fillimisht listën e tyre të zgjedhësve. Unë doja t'ju bëja një pyetje po gjatë shpjegimit tuaj e gjeta përgjigjen, që ju thatë, pra pyetja ime do të ishte që si është procesuar deri më sot? Ke 30 vjet që procesohet në të njëjtën mënyrë dhe këtyre zgjedhësve iu është dhënë një formë ose një formë tjetër, pra mesa shohim kjo e drejtë është tashmë e normuar nga e drejta zakonore. Ndërkohë ne këtu po bëjmë disa normime, në interpretimin edhe në vlerësimin tuaj për t'i dhënë mundësi, edhe frymëmarrje më të madhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por njëkohësisht edhe Gjendjeve Civile dhe drejtuesve të njësive të qeverisjes vendore, që këto detyrime mos të lihen për ditët e fundit për të krijuar dhe vështirësi dhe kolaps. Pra ne nuk është se po bëjmë,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

të kuptojmë një gjë, nuk po bëjmë asgjë të re nga ato që është bërë në 35 vitet e fundit dhe të themi që do t'ju mohojmë të drejtën e votës, tre, katër apo pesë mijë votuese mua nuk më duket dhe në konceptin e përgjithshëm kushtetues, ne kemi bërë shumë debate këtu për shumë të drejta, të gjithë ne dhe kur vjen puna prapë vijmë në një proces dhe themi jo t'ia kufizojmë, pra ne jo vetëm që po jua kufizojmë, po po jua heqim atë që e kanë pasur dei sot. Kështu që unë mendoj që është një koncept i cili është i normuar tashmë, në procesin ligjvënës shqiptar, nuk është se po e vendosim ne. Kuptohet që do të kem dhe argumentat e mia dhe për pjesën kur të vijmë në themel, te pjesa e vendqëndrimit, ku jam dakord me faktin që Kodi Zgjedhor bën fjalë vetëm për vendqëndrimin sepse ju thashë këto elementë të vendqëndrimit lidhen vetëm me përbërësit zgjedhor, përbërës të cilët këta zgjedhës i kanë njëherë të përcaktuar në vendet e tyre. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Dakord. Zoti Nuri ka kërkuar fjalën, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Meqenëse jemi në kuadër të këtij paneli.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Një pyetje kisha për administratën por megjithatë...

Znj. I. Nano: Dakord. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në kuadër të sa kolegët sqaruan apo shprehën mendimet e tyre, bie dakord deri diku me ndihmesën që iu dha kolegja Nano duke shpjeguar dhe duke mundësuar që të kuptohej sikur ne tani po urdhërojmë që ju IEVP-të dhe ju drejtorët e këtyre institucioneve do të bëni për herë të parë atë listën që ju s'e keni ende të bërë apo do të fusni dhe njëherë në "inventar", në thonjëza, personat brenda


*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

institucioneve tuaja. Jo të nderuar! Nuk bëhet fjalë për këtë. Bëhet fjalë, me këtë rast po i jap përgjigje dhe po i kthej përgjigje edhe kolegut Çaka, që askushi nuk tenton t'i heqë të drejtën askujt për të votuar për më tepër, ndërkohë që ne jemi ata që kemi kërkuar që çfarëdo lloj kategorie t'i mundësohet. E dini shumë mirë dhe atë të emigrantëve, të cilët nuk duhet lënë shkas dhe asnjë lloj hapësire dhe për t'u refuzuar pa u përpjekur dhe pa shfrytëzuar të gjithë tentativat e mundshme si KQZ, edhe në këtë rast, edhe për kategorinë e të dënuarve, qofshin të dënuar me akt përfundimtar apo në paraburgim, duhet patjetër t'i jepet mundësia në qoftë se gjykata nuk e ka kufizuar këtë të drejtë, por kriteri është një dhe i vetëm, ai i vendbanimit. Pse duhet ne të nxjerrim një kriter përjashtues për më tepër që unë s'kam një referencë ligjore që ma thotë këtë? Përse duhet unë ta fus përsëri po e përdor atë fjalën në "trick" apo në qorrsokak gjithë këtë proces kur kriteri është i pastër literalisht vendbanimi? Vërtet ai i dënuari figuron në listën e zgjedhësve atje ku e ka pasur vendbanimin dhe këtë nuk ia mohon askush por pse duhet të shpikim ne një proces të ri tashmë? Pra tashmë ta fusim dhe njëherë në një listim nominativ të ri për hir të një kriteri tjetër të shtuar, atë të vendqëndrimit. Shumë e thjeshtë, kriteri i vetëm është vendbanimi, le të prodhojë drejtuesi i atij institucioni listën e cila do të verifikohet më pas nga bashkia dhe këtu po shtoj, që këtu këtij projektakti i mungon dhe një hallkë tjetër, ajo e riverifikimit mbasi prodhohet dhe verifikohet lista nga bashkia kërkohet patjetër një hallkë verifikuese e standardit politik gjithëpërfshirës, ajo e KZAZ-së, të cilën e keni futur diku, rolin e KZAZ-së por përpara se ta marrë ashtu apriori atë listën dhe duke ditur se çfarë ka ndodhur me këto institucione të vuajtjes së dënimit dhe me përdorimin që organet e pushtetit aktual i bëjnë këtyre kategorive, pra kryesisht statistikat nxjerrin që ata votojnë x me 0 në favor të forcës politike në pushtet, këtë e dimë, kemi dhe raste, të Rrogozhinës apo raste të tjera që ndikuan goxha dhe janë të përfshira në raportet shtjelluese të OSCE/ODIHR-it. Kështu që,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

në këtë kuadër le të jemi “fair” me njëri-tjetrin dhe me Kodin minimalisht, të mos shpikim procedura nga e para dhe ne për më tepër juristë në këtë panel të mos votojmë akte të cilat nuk kanë asnjë shtyllë përmbajtësore, nuk përmbahen askund apo t’i japim shansin ndonjë skeme të mundshme, e cila pretendohet të japi ndikimin e saj.

Znj. I. Nano: Zotit Nuri do t’ia japim fjalën?

Z. M. Çakaj: Dakord.

Znj. I. Nano: Dakord. Po zoti Nuri!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit! Unë faktikisht kisha disa pyetje për administratën e KQZ-së.

Znj. I. Nano: Vetëm një ndërhyrje të vogël, se ju erdhët pak me vonesë. Në relacionin që paraqiti zoti Meta u parashtruan të gjitha ato që ju keni dërguar lidhur me aktet.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po vëretje dhe sugjerime. E ndoqa pjesën e fundit të relacionit ku u bë me dije që ishin të përfshira vërejtjet dhe sugjerimet tona.

Znj. I. Nano: U lexuan të gjitha?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po. Unë kisha disa pyetje faktikisht sepse qëndrimin do ta mbajmë edhe më vonë por që ajo që desha të kuptoj është se këtu u tha që, apo

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

të paktën u la të kuptohet se e njëjta procedurë ka ndodhur dhe në të shkuarën, apo e kam gabim? E njëjta procedurë ka ndodhur dhe në zgjedhjet e shkuara, atëherë si ka mundësi që para dy vitesh na ndodhi një problem me Belshin dhe Rrogozhinën, me dy burgjet, ku ne si opozitë humbëm dy bashki për shkak të problemit me votimin në burgje, se politikisht aty nuk ishte problemi nga ana jonë, që juridikisht dhe arritëm në këtë vendim të Kolegjit Zgjedhor ku unë kam qenë përfaqësues ligjor i “Bashkë Fitojmë” dhe arritëm ta marrim përsëritjen e zgjedhjeve në Rrogozhinë pikërisht për problematikën e burgjeve. Çfarë ndodhi aty? Si ka mundësi që aty erdhi lista dhe ishin përfshirë dhe ata që s’kishin të drejtë që të votonin dhe votuan dhe u përmbys rezultati.

Znj. I. Nano: S’kishin të drejtë në kuptim të ligjit të “Dekriminalizimit”? Është tjetër gjë...

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo në kuptimin e hartimit të listave.

Znj. I. Nano: Mirë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Pikërisht pra!

Znj. I. Nano: Mund të mos të kesh të drejtë për të votuar është tjetër gjë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po s’kishin të drejtë, se për këtë po diskutojmë këtu, për vendbanimin.

Znj. I. Nano: Dakord.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po. Atëherë në qoftë se çdo gjë ka qenë vaj në të shkuarën dhe kjo procedurë është ndjekur, ja pra që kemi shembullin më tipik ku ka pasur probleme dhe ne çfarë po kërkojmë? Nuk po kërkojmë ndryshim të rregullës por thjesht zbatimin e vendimit të Kolegjit Zgjedhor, që pati rastin për herë të parë të interpretonte një “casus” kaq specifik. Unë vlerësoj dhe gjykoj që tani këto duhet të reflektohen se nuk mund të injorohen, vendimi i Kolegjit Zgjedhor dhe kriteri i vendbanimit këtu është mjaft i qartë, u tha, nuk ka nevojë ta përsëris prapë për nene dhe dispozita të Kodit Zgjedhor, ku vetëm ja i ka vetë vendimi të Kolegjit të cituara, ku bëhet fjalë për nenin 44, kriteret për të votuar që duhet të jesh mbi 18 vjeç, të jesh i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit. Nuk e ka, nuk e ndan neni në këtë rast se bëhet fjalë për zgjedhje bashkiake, zgjedhje vendore apo zgjedhje për Kuvend, janë të përgjithshme, po ashtu dhe neni 46 i Kodit Zgjedhor, 56 e me radhë. Pra unë këtë nuk kuptoj, këtu kemi të bëjmë me një kriter, ju thoni vendqëndrimi sepse ju përmendni vendqëndrimin, e keni të renditur në këtë bazë po themi ligjore sepse thoni që i referohet Kodit Civil apo jo se ku qëndron mbi tre muaj në institucion të caktuar, po themi spitalet, burgje e me radhë duhet që të ketë vendqëndrimin dhe prandaj e listoni këtë apo jo? Po mirë kam një pyetje tjetër, pse nuk e harton KQZ-ja një listë edhe për spitalet me vendqëndrime mbi tre muaj? Pse nuk harton KQZ-ja një listë edhe me shërbimin ushtarak, pra kush janë këta persona që kanë detyrime të tjera sipas Kodit Civil? Meqenëse në Gjendje Civile figurojnë ata, siç e tha edhe zoti Çaka, po figurojnë në Gjendje Civile si votues në bashkitë përkatëse në listat përkatëse. Pse nuk merr KQZ-ja një iniciativë që të bëjë dhe lista të tilla dhe t’ia dërgojë këtyre institucioneve, për të parë a kanë të drejtë të votojnë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

aty apo jo ku ushtrojnë po themi detyrën apo ku janë në spital mbi tre muaj. Këto dy pyetje kisha. Pra nuk e di në qoftë se keni nevojë t'jua riformuloj.

Znj. I. Nano: Po zoti Meta.

Z. E. Meta: E filloj nga pyetja e fundit, pse nuk e merr KQZ-ja iniciativën për të rregulluar listën e zgjedhësve për sa i përket institucioneve të tjera të posaçme. Deri më tani problematikat e hasura, me të cilat ka pasur vendim të gjykatës kanë qenë lidhur vetëm me të burgosurit, pra nuk ka pasur një problematikë të raportuar me ushtrimin apo mosushtrimin e të drejtës së votës nga persona të tjerë, persona që janë në institucione ku pranohen pacientë apo në ushtri apo polici.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë në lidhje me diskutimet që po shtrohen këtu sidomos, veçanarisht në lidhje me atë çfarë deklaroi kolegu Çaka, së pari vlen të theksojmë faktin se nenin 45 të Kushtetutës sigurisht që parashikohet që çdo shtetas shqiptar me mbushjen e moshës 18 vjeç ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, por jo më larg se dy-tre mbledhje më para sjell në vëmendjen të tre kolegëve që kur ne propozuam që kjo e drejtë universale, kushtetuese të përfshihej dhe për ata shtetas shqiptarë të cilët e kanë fituar këtë të drejtë në bazë të Kushtetutës. Pra është një e drejtë kushtetuese, pavarësisht nëse kanë apo jo dokument shqiptar sepse për sa kohë ai e ka dokumentin, identifikohet, dokumentin biometrik, identifikohet kudo, në SHBA, në BE e në Kanada, atëherë automatikisht edhe në Shqipëri identifikohet dhe ai dokumenti do të vlejë vetëm për efekt identifikimi. Nga kolegët nuk u pranua me argumentimin dhe me pretendimin se shiko është e vërtetë që shtetasi shqiptar e ka

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

këtë të drejtë kushtetuese por ka disa procedura, ka dhe disa ligje dhe posaçërisht na u referua, pavarësisht se neni 105 i Kodit Zgjedhor nuk e përcakton specifikisht dokumentin e identifikimit shqiptar na u referua kjo, pra nuk mund të votojë shtetasi, emigranti shqiptar, i cili nuk disponon një dokument shqiptar identifikimi, pra paskami ca procedura dhe me këtë logjikë e hodha. Çfarë ndryshoi në këtë akt që tani përmendet e drejta universale kushtetuese e votës? Si, është më i rëndësishëm një i burgosur sesa një shtetas emigrant shqiptar? Unë nuk besoj. Janë, po është shtetas shqiptar është i barabartë dhe po biem dakord për parimet, për procedurat, për parashikimet e normuara në ligjin zgjedhor do të biem dakord për të gjitha, pra duhet të jemi koherentë për këtë së pari. Së dyti në referencë të asaj që ju relatuat duhet të kemi në konsideratë diçka, që edhe vendimi i Kolegjit Zgjedhor ku bëhej fjalë për zgjedhjet për bashki ka një ngjashmëri dhe ka një analogji dhe me sistemin për zgjedhje për Kuvendin shqiptar. Ta them më thjeshtë, e di çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që një shtetas shqiptar i cili është i regjistruar në zonën zgjedhore në qarkun e Tiranës, duhet të votojë në Tiranë. Nëse ky shtetas ndodh që është i burgosur dhe është në fije, atëherë për kë i bie të votojë? Për deputet e zonës zgjedhore të tij? Jo, ia ndalon Kodi Zgjedhor. Ai do të duhet të ketë dhe në referencë dhe në respekt të Kodit Civil vendbanimin dhe në respekt të neneve 44 dhe 45 të Kodit Zgjedhor do të duhet të ketë vendbanimin në mënyrë që të votojë në po themi në burgun e Fierit. Ky është kriter i patjetërsueshëm së pari. Së dyti...

Znj. I. Nano: Të na kishe marrë shembull ndonjë burg tjetër koleg!

Z. M. Çakaj: Po Durrësin, meqë e doni burg tjetër, Durrësin! Përsëri nuk voton dot në Tiranë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Znj. I. Nano: Ka dhe të tjera, ka dhe Tiranë.

Z. M. Çakaj: Patjetër po ata të Tiranës s'votojnë në Tiranë, s'ka se humbasin ata.

Znj. I. Nano: Ku i dihet ku e kanë vendbanimin!

Z. M. Çakaj: Nuk e dimë, po flasim tani. Së dyti duhet të kemi në konsideratë faktin që dhe unë e ftoj administratën, ajo hallka që i mungon nuk mund ta lëmë edhe bile këtu unë s'jam dakord dhe me kolegen Vukaj që të fusim KZAZ-në, ajo hallka, së pari ne duhet të normojmë aktin dhe akti duhet të jetë i qartë. Kriteret e nenit 44 dhe 45 të Kodit Zgjedhor duhet të jenë të qarta, pra aty në listën e zgjedhësve që votojnë në qendrat posaçme duhet të jenë patjetër zgjedhësit të cilët e kanë përfituar, së pari janë me të drejtë vote dhe së dyti duhet të kenë se s'bën, duhet të plotësojnë kriteret për të qenë në listën e zgjedhësve. Këto dy kushte na i detyron Kodi pastaj për të drejtën zakonore nuk e shpikim dot ne s'e ka bërë dot as Lekë Dukagjini, megjithatë ky është tjetër histori. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Të drejtën zakonore, KQZ-ja! Zonja Xhina, pastaj zoti Çaka.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Faleminderit! Atëherë nëse do të shqyrtojmë aktin final që ka sjellë sot administrata, në fakt është një akt që specifik pasi i referohet vetëm zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 maj 2025, kjo provon qartësisht që jemi në një ekuivok sepse në fakt duhet një akt rregullator që të përcaktojë shprehimisht çfarë ndodh në zgjedhje. Pra shoh që ka qenë ndoshta një urgjencë që na ka ardhur ky propozim për zgjedhjet e kësaj radhe sepse që të kemi një procedurë të qartë duhet një akt rregullator i qartë, që duhet të zgjidhte këto diskutime që ne

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

jemi duke bërë sot. Nuk mund të them që nuk ka të drejtë kolegu Çaka apo nuk ka të drejtë kolegu Çaka, apo kolegu im i Partisë Demokratike, të gjithë në një farë mënyre kanë të drejtë në këtë lloj diskutimi, por duhet parë çfarë prevalon në këtë rast dhe jo më kot përmenda titullin e aktit. Akti i referohet zgjedhjeve për Kuvend dhe meqenëse jemi të gjithë këtu duke përmendur vendimin e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor Tiranë, ai vetë i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2007, nr. 40, i cili kur bën referimet e tij lidhur me pretendimet e palëve jo më kot përmend dhe specifikon rastin kur janë zgjedhjet për Kuvend dhe rastin kur janë zgjedhjet lokale për kryetarët e bashkive. Nuk ka nevojë ta lexoj se e kemi lexuar të gjithë, përmend shumë mirë atë lidhjen që ka në rastin e zgjedhjeve lokale dhe zgjedhjes së kryetarit të bashkisë, pra aty ku ai zgjedhësi ka juridiksionin, ku merr shërbimet publike, ku merr të mirat që ofron ajo njësi administrative. Ndërsa në rastin për Kuvend bën pikërisht atë lidhjen që është shumë interesante ku thotë që çdo deputet nuk i përket vetëm një zone të caktuar por është deputet i gjithë Shqipërisë, në këtë rast zgjedhësi nuk ka rëndësi që duhet të jetë patjetër i lidhur me vendbanimin. Ky është interpretimi që bën vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe nëse flasim për hierarki të akteve apo vendimeve mendoj që mbi vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të bëjmë diskutime për vendimin e Kolegjit Zgjedhor në këtë rast dhe nëse do t'i referohemi sërish Kodit Civil. Kodi Civil në nenin 14 të tij na thotë “Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për kryer punë ose detyra të caktuara për të vazhduar një shkollë ose kur kurs të caktuar, për t’u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal dhe për rastet të tjera të kësaj natyre”. A mund të themi që është shterues kjo dispozitë? Nuk mund ta themi dot. Po ata që janë në paraburgim që nuk janë duke vuajtur dënimin penal ku do t’i çojmë ata, si do t’i quajmë ata, s’ka vendbanim, s’ka vendqëndrim? Nuk e parashikon Kodi Civil këtë rast për personat që janë në paraburgim, nuk janë duke vuajtur ndonjë dënim penal, atëherë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

hajde t'i ndajmë këta që janë duke vuajtur dënimin, e këta që janë duke pritur për të përfunduar gjykimin, një rast ky. Le të marrim rastin që kemi tani prezent, kemi rastin për shtetasit që po votojnë jashtë vendit, ku e kanë vendqëndrimin këta? Pse po votojnë atje? A është një rast specifik ky? Pikërisht dhe rasti i personave që janë në institucione të posaçme janë raste specifike që janë, bëjnë përjashtim, që njihet nga të gjithë e drejta që në kohën e latinëve, përjashtimi nga rregulli dhe janë raste që prevalojnë, kur kemi përjashtim nga rregulli tregon se ekziston një rregull i përgjithshëm që përjashton raste që nuk kanë parashikime ligjore. Për sa kohë këtu kemi një parashikim të qartë ligjor që s'mund të përmendim Kodin Civil dhe të harrojmë ligjin për Gjendjen Civile, nuk mund të përmendim vendimin e Kolegjit Zgjedhor dhe të harrojmë vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe nuk po përmendim Kodin Zgjedhor dhe të harrojmë Kushtetutën. Kështu që mendoj që duhet të vijojmë me miratimin e aktit për t'i shërbyer zgjedhjeve dhe për t'i dhënë të drejtën të votojnë se duke parë dhe numrin sa shumë paskemi këtu për institucione mendoj që duhet urgjentisht ta miratojmë aktin. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë unë jam sinqerisht, e vlerësoj jashtëzakonisht shumë këtë relatim që ju bëtë dhe merakun tuaj për t'i dhënë të drejtën e votës dhe mundësinë për të votuar 2670 të burgosurve dhe po të shikoni pak numrin atje te tabela që e kemi në kohë reale janë 220 000 shtetas shqiptarë të regjistruar, nga 1.3 milionë shtetas shqiptarë me të drejtë vote. Sa mirë do të ishte sikur të kishim dhe për 1.1 milionë të tjerë të njëjtin merak dhe t'ua jepnim mundësinë, të paktën për 170 mijë të cilët e kanë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë po ne këtu nuk e arritëm dot konsensusin t'ua jepnim të drejtën e votës. Pra gjithë kjo luftë për 2670

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

të burgosur dhe një neglizhencë totale për 1.1 milionë shtetas shqiptarë me të drejtë vote që ndodhen jashtë kufijve për arsye të tyre dhe e kemi rrëzuar me lehtësinë më të madhe. Unë sinqerisht e vlerësoj këtë relatimin tuaj po do të doja të ishim në të njëjtën linjë me zbatimin e të drejtës kushtetuese të votës. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: E dëgjova relatimin e zonjës Xhina, si gjithmonë është e përpiktë në teknikën legjislative apo në argumentet e saj, por do të thosha një theksim të vogël ose një saktësim esencial, nuk bëhet fjalë për të penguar askënd të votojë, nuk bëhet fjalë për t'i ndryshuar apo për t'u përpjekur t'i heqim të drejtën e garantuar nga kushtetuta, pra të gjithë duhet të votojnë por duhet të votojnë sipas kriterëve të ligjit, pra bëhet fjalë, e nderuar edhe pse na duken shumë këto qendra të IEVP-ve, Shkodra mbante numrin kryesor me 299 të dënuar, më pas vjen Fieri 298 dhe Peqini, 256. Pra nuk bëhet fjalë për heqjen e së drejtës për të votuar, po bëhet fjalë për të gjithë ata të dënuar të cilët kanë vendbanimin në Fier, kanë vendbanimin në Shkodër, kanë vendbanimin në Peqin, Lezhë, Burrel, Lushnje e kështu me radhë. Pra ky është saktësimi me të cilin nuk duhet "abuzuar" ose nuk duhet t'i japim një frymë tjetër nga ç'është e vërteta, pra jemi të gjithë katërcipërisht dakord që t'i jepet mundësia çdo shtetasi shqiptar të votojë, por jo duke ndryshuar kriteret që ka Kodi Zgjedhor. Kriteret e Kodit Zgjedhor janë një dhe të vetme për të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht gjendjes së tyre sociale, kulturore, politike apo ligjore. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Zoti Çaka.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Z. D. Çaka: Faleminderit! Atëherë, në radhë të parë do ta falenderoja zonjën Xhina sepse pak a shumë ishte kjo pjesa e arsytimit që do të bëja mbas përgjigjes së kolegut Çakaj në interpretim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të faktit që përveçse nuk jemi në zgjedhjet për pushtetin vendor, ku i shtrin efektet vendimi i Kolegjit Zgjedhor, kemi dhe këtë interpretim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2007, pra që deputeti nuk përfaqëson zonën zgjedhore por të gjithë Shqipërinë. Pra çdo zgjedhës dhe madje ai interpretim ka qenë shumë i saktë kur ka përcaktuar pikërisht edhe të drejtat për atë kohë kur për zgjedhjet e pushtetit vendor ishte përcaktuar vendbanimi dhe për zgjedhjet e pushtetit të Kuvendit nuk ishte i përcaktuar, por të them të drejtën pavarësisht kësaj do të doja ta falenderoja dhe zotin Nuri sepse me thënë të drejtën që në kundërshtimet e tij që na ka çuar në email, e ka cituar këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese që unë mendoj në vlerësimin tim vjen në ndihmë të këtij shqyrtimi, ndërsa për sa i përket vlerësimit që bëhet që nga ana jonë është mohuar e drejta për 270 000 votues të cilët jetojnë jashtë. Në radhë të parë duhet t'ju them të nderuar kolegë që nuk është pjesërisht e vërtetë i gjithë interpretimi, nuk duhet marrë i cunguar, interpretimi që kemi bërë për këta zgjedhës lidhet me faktin jo vetëm të dispozitave ligjore që mungon dhe ndërkohë në këtë rast që ne po diskutojmë sot është e përcaktuar, ndërkohë kanë qenë shumë elementë që ne kemi refuzuar zgjedhjen, pra votimin e votuesve nga jashtë vendit me dokumenta të huaja, siç ka qenë një mungesa e bazës ligjore, e dyta ka qenë mungesa e barazisë me zgjedhësit që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë që ne kemi theksuar sepse ajo dispozitë është e njëjtë si për ata jashtë dhe ata brenda, por dhe ata që janë brenda, ndërkohë ne bënim një ndarje të tyre duke mos ua dhënë dhe këtë të drejtë dhe ndërkohë flasim për dy elementë të ndryshëm, po flasim për dy elementë të cilët ata që janë votuesit që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, zgjedhja e tyre është vullneti i tyre si për të mos u pajisur me dokumenta

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

identifikimi ashtu edhe duke mos ardhur këtu dhe për t'i bërë ato dhe për të votuar, pra është vullneti i tyre, ndërkohë për ata zgjedhës të cilët ndodhen në institucione e vuajtjes së dënimit nuk kemi më zgjedhje të tyre, ata nuk e kanë mundësinë me vullnetin e tyre të lirë që të plotësojnë këtë të drejtën e tyre kushtetuese dhe këtë po ua mohojmë ne në këtë rast dhe ashtu siç e thashë dhe njëherë ne nuk shpikim rrotën këtu se më duket sikur ne po bëjmë çdo gjë nga e para, po ka 35 vjet që bëhet i njëjti proces dhe nuk mund të themi çfarë ndodhi në Peqin dhe me çështjen e Rrogzhinës dhe u anuluan zgjedhjet, të cilët pamë të njëjtin rezultat. Pra s'po bëjmë asgjë të re, po bëjmë që këtyre 3036 votuesve t'ua mohojmë këtë të drejtë dhe me të drejtë është pyetja e zonjës Xhina, janë 2607 në paraburgim dhe janë 429, atëherë i bie që shumicës dërrmuese ne po jua heqim sepse ligji për Gjendjen Civile nuk e përmendka Kodi Civil, nuk e përmendka këtë term. Çfarë janë këta të paraburgosur, pra nuk ëshë njësoj, në qoftë se ne duam të bëjmë një analizë, hajde ta bëjmë një analizë, nuk mund të bëjmë paralelizma, jo e mohuat atëhere, sot po mbroni këtë të drejtë, nuk iu mohua asnjë e drejtë, të gjithë zgjedhësit që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë natyrisht që e kanë këtë mundësi, le të vijmë në Shqipëri, të bëjnë dokumentat dhe mund të votojnë atë ditë, është zgjedhje e tyre, po çfarë t'iu bëjmë këtyre zgjedhësve që janë në burg, apo t'iu themi dilni ca ditë nga burgu, shkoni votoni dhe kthehuni prapë se kjo është logjika për mua, pra vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i qartë, tani në qoftë se ne duam të bëjmë një diskutim që prevalon vendimi i Kolegjit për zgjedhjet e përgjithshme gjithmonë.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Koleg i nderuar! Vendimi i Kolegjit nuk të përcakton ty si kriter vendqëndrimin dhe po e ritheksojmë dhe ritheksojmë dhe njëherë, ritheksoj dhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




**Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025**

njëherë për të pestën herë që nuk bëhet fjalë për heqjen e së drejtës për të zgjedhur, në këtë rast bëhet fjalë për ndjekjen e kriterit universal, atë të vendbanimit, nuk munden të votojnë të gjithë të dënuarit që janë në burgun e Shkodrës të cilët nuk kanë vendbanimin aty, por do votojnë ata që kanë vendbanimin aty sepse ju ndoshta i patë si grup vulnerabël para një momenti duke thënë që këta të gjorë nuk dinë sesi të votojnë, pikërisht pra ky është merakuri që do t'i përdorin për të votuar edhe këto lista në qoftë se ju do të vendosni apo ne do të votojmë kriterin që s'e ka Kodi, atë të vendqëndrimit.

Z. M. Çakaj: Edhe diçka, që të jemi korrekt edhe me Kodin Civil dhe sigurisht më pas edhe me Kodin Zgjedhor, tani përpara se të shkojmë te neni 14 i Kodit Civil, vendqëndrimi ka dhe dy nene më para, është neni 12 i Kodit Civil, vendbanimi dhe banimi dhe qëndrimi, i ndan qartësisht Kodi Civil, banimi është vendi ku personi për shkak të punës apo shërbimit të përhershëm, vendodhjes të pasurisë apo të realizimit të interesave të veta qëndron zakonisht ose në të shumtën e kohës, çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij, personi nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një vendbanim. Tani Kodi Civil, të nderuar, siç e dimë është miratuar në vitin '95 dhe Kodi Zgjedhor është miratuar më pas, ka pësuar disa ndryshime, i fundit ishte datën 17 shkurt të vitit 2025, tani duhet të biem dakord që të gjithë që ligjvënësi e ka pasur shumë të qartë në momentin që ka hartuar nenin 44 dhe nenin 45 të Kodit Zgjedhor ku referuar Kodit Civil e ka pasur të qartë ndarjen neni 12 vendbanimi, banimi i përhershëm dhe neni 14 vendqëndrimi dhe jo pa qëllim ligjvënësi ka vendosur si kriter të patjetërsueshëm nenin 44 dhe nenin 45 vendbanimin, kjo është e qartë, nuk ka nevojë për diskutim. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Shumë lirisht e zgjedh një i burgosur me 15 vjet burg ku të votojë!

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Z. M. Çakaj: Urdhëro!

Znj. I. Nano: Shumë lirisht e zgjedh!

Z. M. Çakaj: Mua më merakos gjë tjetër, më merakos gjithë ky debat për të burgosurit, sa mirë do të ishte t'i analizonim për 1.3 milionë votues

Znj. I. Nano: Po tani s'kanë bërë kërkesat, 272 000 janë me kërkesa, edhe nuk e dimë.

Z. M. Çakaj: Jo, jo janë sa të duash ata me kërkesa por problemi është po pra se i kemi normuar.

Znj. I. Nano: Zgjedhës unik.

Z. M. Çakaj: Po pra i kemi normuar ne dhe sigurisht Kodi Zgjedhor siç ka parashikuar disa kriteret të caktuara edhe këta shtetasit shqiptarë i kemi normuar, është dhe proces i ri, unë uroj të shkojë dhe 500 mijë dhe 600 mijë, por ky diskutim për dy mijë apo tre mijë të burgosur të cilët duhet të votojnë.

Znj. I. Nano: Edhe për një, kemi thënë në mbledhjet e tjera, zonja Vukaj këtu ka qenë, edhe për një...

Z. M. Çakaj: Edhe për një, jam shumë dakord po s'më rezulton që e keni mbajtur këtë standard, është standard nuk është...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Znj. I. Nano: Atëherë unë ju ftoj ju që keni mbajtur atë standard ta ruan standard dhe në diskutimin e sotëm. Zoti Çaka.

Z. D. Çaka: Në lidhje me këtë diskutim sepse po shtrohet pjesa e dy qëndrimeve, në radhë të parë, në qoftë se mbani mend, pakti që kemi bërë dhe të paktën që unë kam bërë këtu ka qenë pikërisht për mohimin e së drejtës sipas jush të votës së emigrantit jo me faktin se e kemi ne apo s'e kemi ne të drejtën, pra duhet ta përcaktonim ne se atyre nuk iu lejohen ajo çfarë unë kam thënë në qoftë se e mbani mend ka qenë një debat që ne e kemi bërë të dy zoti Çakaj, ka qenë fakti që u ngrit në nivel diskutimi në Kuvend dhe Kuvendi nuk e përcaktoi në Kod një gjë të tillë dhe madje kemi bërë debat, është votuar apo s'është votuar në Komisionin për Çështjet Ligjore në Kuvendin e Shqipërisë. Pra fakti që ne ngritëm si argument ishte që Kuvendi nuk e mori, e rrëzoi në Komision, nuk u fut në seancë më pas një shqyrtim i tillë dhe nuk kishte të bënte me faktin që jo baza ligjore mungon ose nuk mungon sepse vetë Kuvendi e tha këtë dhe nuk ishte interpretimi ynë ishte interpretimi i Kuvendit të Shqipërisë që e kishte bërë një gjë të tillë. Ndërkohë për sa i përket, unë jam dakord me ju që neni 12 i Kodit Civil legjislatori e ka pasur parasysh në normimin e Kodit Zgjedhor në këto momente, po. Po çfarë thotë dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, në këtë kuptim vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënies jetësore të njeriut. Atëherë, po Kuvendi i Shqipërisë kur e ka miratuar votuesi nga jashtë e ka pasur parasysh këtë fakt se unë nuk di që këta 1.1 milionë shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ta kenë qendrën e marrëdhënieve të tyre sociale, kulturore Shqipërinë votojnë jashtë. Pra bie argumenti që raporti që ka pasur në këtë momente Kuvendi i Shqipërisë, duke qenë se Kodi Civil është i '95, e pasur parasysh gjithë këto dhe po t'i hyjmë dhe interpretimit. Çfarë thotë Kodi Zgjedhor, prapë neni

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

45, 46 që ju citoni, lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, përfshin jo vetëm zgjedhësin me vendbanim jashtë vendit, pra në qoftë se do të ishit të konceptit prapë i vendbanimit, pra rezulton që jemi në të njëjtat kushte, për këta zgjedhës nuk plotësojnë as kriteret dhe as përbërësit zgjedhor. Atëherë pse këta po i lejokemi ne për të votuar? Kjo është pyetje retorike jo se është pyetje që unë e bëj, prandaj koncepti i përgjithshëm, qëllimi i përgjithshëm pavarësisht ku ndodhet personi ai duhet të votojë dhe mundësia në këtë rast, mundësia e këtyre zgjedhësve që ndodhen brenda IEVP-ve nuk ekziston për ta zgjedhur, se ai mund të votonte dhe tek zona zgjedhore,ku, po si do të shkojë të votojë? Si do të shkojë të votojë? Është e pamundur që të shkojë të votojë atje dhe thashë edhe njëherë nuk po e bëjmë sot për herë të parë se tani duket sikur po bëjmë një diskutim ne edhe ne tani këtu o ia mohojmë o s'ia mohojmë, pra 35 vjet që bëhet kjo, po s'e bëjmë këtë atëherë ne e mohojmë, po s'e bëjmë këtë e mohojmë.

Znj. I. Nano: Po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë keq më vjen po më duhet ta përsëris, në fakt po më shqetëson ky insistimi juaj për t'u dhënë të drejtën në kundërshtim me Kodin Zgjedhor të burgosurve dhe të paraburgosurve, të drejtë të cilën ata e kanë nëse plotësohen kriteret e Kodit Zgjedhor së pari. Së dyti keni parasysh zoti Çaka që ligjvënësi, pra Kuvendi i Shqipërisë të drejtën e votës së shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit e ka materializuar në Kodin Zgjedhor, e ka materializuar në nenin 24, 25, 25/1 dhe sigurisht dhe neni 46, ku ka parashikuar listën e zgjedhësve, nëse Kuvendi i Shqipërisë do të kishte qëllim që të ndryshonte pikërisht këtë kriterin vendqëndrim dhe vendbanim në respekt dhe të Kodit Civil, ta materializonte në Kodin Zgjedhor por nuk e ka pasur gjithë këto ndryshime nga 2007 kur është marrë i Gjykatës

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Kushtetuese e deri në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor të datës 17 shkurt nuk e ka parë të arsyeshme, nuk e ka ndryshuar. Është i qartë Kuvendi, nuk ka asnjë lloj diskutimi për këtë dhe në lidhje me atë që ju deklaruat. Ne na falenderoi dhe zoti Majko, nuk e di e mësoi emrin e funksionit tonë apo jo, po ne na falenderoi publikisht në Kuvend, pavarësisht se nuk ishte i vëmendshëm të kuptonte që votuam 3 me 2, po tha unanim, pra nuk kaloi akti, po tjetër histori kjo, urojmë të jetë në zgjedhjet e ardhshme i vëmendshëm. Kështu që besoj se debati është i qartë nëse plotësojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor ne jemi dakord ta miratojmë, ta fitojnë të drejtën e votës siç parashikon ligjvënësi, nëse jo unë jam kundra në parim të këtij akti.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Dakord dhe unë, mesa parashtroi kolegu Çakaj, dakord edhe në qoftë se i thërrasin ndërgjegjes edhe njëherë propozuesit dhe i referohen edhe njëherë Kodit Zgjedhor për të sjellë referencën e duhur dhe referencën e cila vlen për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe nuk është e ndryshueshme dhe s'ka përjashtime për këtë referencë. Dakord që kjo e drejtë t'i mundësohet të gjithë atyre që vuajnë dënimin por që kanë vendbanimin në qendrat e votimit përkatëse aty ku vuhet dënimi.

Znj. I. Nano: Ajo s'ka nevojë fare për dakordësinë tonë tuaj pastaj, të secilit prej nesh apo të gjithëve bashkë. Zoti Çaka.

Znj. H. Vukaj: Që të ecë akti po patjetër që ka nevojë për dakordësinë tonë!

Znj. I. Nano: Fare s'ka nevojë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Znj. H. Vukaj: Për dakordësinë tonë? Patjetër se është 4 me 1!

Znj. I. Nano: Fare! Të asnjërit prej nesh dhe të gjithëve bashkë nuk ka nevojë!

Z. D. Çaka: Në qoftë se me të vërtetë legjislatori ka normuar pjesën e dispozitave e votuesit nga jashtë, por duhet të kemi parasysh dy gjëra, e para për votuesit nga jashtë është hera e parë nuk ka qenë si proces i realizuar, kjo nuk është hera e parë. Madje për t'i bërë të mundur këtë votim duhet të marrim dhe atë vendimin deklarativ për të votuar, ndërkohë për zgjedhësit të cilët ndodhen në këto institucione jo vetëm që s'kemi nevojë po ndërkohë legjislatori nuk e ka parë të nevojshme vendbanimin dhe vendqëndrimin sepse kjo ka 35 vjet që bëhet dhe nuk ka pasur ndonjëherë probleme. Po flasim për zgjedhjet qendrore, pra zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë mos të hedhim grepin të zgjedhjet e pushtetit vendor për ta bërë më të lezeçme pjesën e diskutimit, se s'ka lidhje. Ne po diskutojmë një akt i cili është vetëm për këto zgjedhje, nuk po diskutojmë për parimin e vendqëndrimit apo vendbanimit dhe në qoftë se do të ishte kjo pikëpyetje do e kishin zgjidhur dhe anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë, po jo sepse për ta është e qartë, ka 35 vite në zgjedhjet për Kuvend, është votuar në këtë format.

Znj. H. Vukaj: Mund të na sjellës i nderuar koleg një akt këtu i cili thotë votohet dhe kriter është vendqëndrimi, meqenëse ju mbani mend që ne paskemi shkelur Kodin Zgjedhor më përpara, ma sill më herët këtu, çfarë kemi votuar ne...

Z. D. Çaka: Atëherë janë të gjitha vendimet e Gjykatave të cilët kanë...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Znj. H. Vukaj: Ne këtu çfarë kemi votuar? A kemi votuar një kriter përjashtues nga ai që përcakton Kodi Zgjedhor?

Z. D. Çaka: Jo.

Znj. H. Vukaj: Sepse kjo është e rëndë, të thuash që kemi ngritur prej 30 vjetësh ku përfshihemi edhe ne në këto katër vite mandat, një praktikë ku i lejohet atyre që kanë vendqëndrimin atëherë na e sill në kujtesë kur...

Z. D. Çaka: Kanë shkuar në gjykatë atë që kanë marrë këto lejet...

Znj. H. Vukaj:...sepse personalisht nuk mendojmë që kemi shkelur ndonjëherë Kodin, kurrë!

Z. D. Çaka: Jo, jo ne, nuk thashë që kemi shkelur ne.

Znj. H. Vukaj: Dhe as kemi ndryshuar standardin dhe as përshtatur standardin për çfarëdo lloj zgjedhje, për asnjë lloj zgjedhje!

Z. D. Çaka: Të lutem mos më vër në gojë fjalë që nuk i thashë! Nuk thashë që e kemi bërë ne dhe 35 vite këta zgjedhës kanë votuar dhe kanë qenë të gjithë ato gjykata që të gjithë ato kërkesa që këta zgjedhës të votojnë atje ku kanë vendbanimin po aty ku kanë vendqëndrimin dhe në qoftë se këto vendime gjykatash që janë pa vlerë, atëherë po, dakord.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Z. M. Çakaj: Atëherë diçka, më fal!

Znj. I. Nano: E fundit z. Çakaj

Z. M. Çakaj: Ne të gjithë kemi qenë dëshmitarë të zgjedhjeve, të procesit zgjedhor dhe sigurisht dhe të kuadrit rregullator që ne kemi miratuar në vitin 2021, që ishte vit i vështirë. Sjell në vëmendjen tuaj që parimisht kemi rënë dakord, një presion shumë i madh atëherë nga të gjithë, edhe subjektet politike po edhe palët e interesuara edhe nga populli, ka qenë fakti nëse duhet të ngriheshin qendra të posaçme, duke qenë se ishim në situatën “covid”, duhet të ngriheshin qendra të posaçme në spitale apo jo? Të gjithë kemi rënë dakord dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Celibashi e ka deklaruar që nuk ngrihen qendra të posaçme në spitale, për të gjithë arsyet, së pari. Së dyti ne duhet të ndajmë diçka këtu, diskutimi është juridik, në bazë të 44, 45 të Kodit Zgjedhor, sigurisht dhe të Kodit Civil apo është politik? Nëse diskutimi është politik është tjetër histori, diskutimi juridik ligjor është i qartë, kodi zgjedhor është i qartë, unë personalisht jam kundër çdo propozimi i cili bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, atë çfarë ka dashur ligjvënësi dhe Kuvendi i Shqipërisë e ka materializuar në Kodin Zgjedhor, qoftë për votën e emigrantëve, qoftë për votën e të burgosurve apo të paraburgosurve, kriteret janë të qarta. Nëse ka paqartësi, atëherë ne si Komision Rregullator pas këtij votimi i bëjmë kërkesë dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, meqë në Kodin Zgjedhor parashikohet që ai përfaqëson KQZ-në dhe bën dhe propozime, sigurisht pasi i konsultohet me ne, bën propozimet Kuvendit, në ndryshimet e mundshme të Kodit Zgjedhor shtesa, sugjerime, paqartësi, të bëjë dhe një propozim për rastin konkret dhe le ta zgjidhi Kuvendi, po kështu siç është nuk është në përputhje projektakti i paraqitur.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj dhe kolegë, thjesht doja të shtoja diçka në atë që thatë ju, lidhur me diskutimin ligjor, diskutimi ligjor nuk nis dhe nuk mbaron vetëm te Kodi Zgjedhor, përkundrazi ne këtu referuam vendimin e Kolegjit Zgjedhor, i cili është për një çështje të caktuar dhe do të mund të merret si referencë për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, referuam dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Pra nuk mbetemi vetëm këtu sepse ka pasur çështje të cilat kanë pasur nevojë për interpretim në Gjykatë, është e drejta e paleve të ankimojnë çdo vendim tonin, të Komisionerit, të KAS-it dhe fakti që ka arritur në 2023 në Kolegj, më herët akoma në Gjykatë Kushtetuese do të thotë që ka pasur çështje të interpretueshme, pra për faktin që ndoshta Kodi Zgjedhor apo mënyra e zbatimit nga organet zgjedhore, Kodi Zgjedhor nuk ka qenë ajo e duhura, pra ne nuk mund të kufizohemi vetëm këtu, madje unë do të shtoj dhe diçka tjetër që i gjithë ky diskutim u ngrit dhe mbi bazën e një paragjykimi se për kë, për cilin subjekt votojnë të burgosurit apo të paraburgosurit, pra ta paragjykos një çështje të tillë mua nuk më duket serioze nga ana jonë si juristë, ne nuk e dimë si voton cilido, kudo që voton. Gjithsesi ne besoj që shteruem një debat të vlefshëm padyshim në kuadër të diskutimit në parim të projektvendimit, nëse nuk kemi diçka tjetër? Keni ju zoti Nuri në parim tjetër?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Në parim, po e nderuar, përpara se ndoshta të kaloni në fazën tjetër, unë si përfaqësues i Partisë Demokratike i shpreha shqetësimet e mia, i kam shprehur dhe me email në dy raste, kur jua kemi përcjellë qëndrimin. Ajo që dua të nënvizoj këtu është që nëse akti do të arrihet të formulohet në mënyrë më të qartë, më të shprehur, pra të shprehet në mënyrë të qartë fakti se listat, pavarësisht se kush janë ato në vetvete dhe kush e ka detyrën aty në IEVP, se kush janë këto, por ajo që është më e rëndësishmja, në vlerësimin tonë është që të dalë e qartë që kanë të drejtë të votojnë ata kanë vendbanimin, pra ky kriter duhet që të figurojë i

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

qartë në këtë draft apo në këtë akt, sikundër është e parashikuar që të hiqet nga lista ata persona që nuk kanë të drejtë të votojnë me vendim gjykatë, mendojmë që mund të përfshihet dhe ky element aty, në mënyrë që mos të ketë konfuzion termash, pavarësisht sepse në të njëjtin akt, në të njëjtën fjali, një fjali më mbrapa është dhe vendqëndrimi, mund të jetë dhe vendbanimi si kriter që është i parashikuar në Kod, pra ata titullarë institucionesh, qoftë titullari i IEVP-së, qoftë kryetari i bashkisë, qoftë titullari i Gjendjes Civile përkatëse, që do të jenë të ngarkuar me zbatimin e këtij akti apo me hartimin e listave të mos kenë shteg për devijime dhe në një zonë të zbatohet ndryshe dhe në një zonë tjetër ndryshe, por akti të jetë i qartë dhe të shprehen këto kritere në mënyrë të qartë dhe pa ekuivoke, të mos lihet në dorë të diskrecionit të cilit titullar të institucionit sesi do ta zbatojë ligjin. Ky do të ishte propozimi ynë. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Nuri! Atëherë i mbyllim diskutimet në parim, s’kemi diçka tjetër, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e rregullave për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës të zgjedhësve dhe krijimin e komisionit të qendrës së votimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, kush është dakord?

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Akti nuk miratohet!

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 3.03.2025*

Akti nuk miratohet në parim, kështu që nuk mund të vijojë shqyrtimin më tej për shkak se nuk ka shumicën e duhur prej 4 votash. Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 15

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

